

**Një pjesëtarë i familjes me të cilin jetojmë së bashku duhet të bëjë një Test-Corona.
Cfare duhet të bëjë unë?**

- Personi që ka bërë Testin ju lutem të qëndrojë në shtëpi derisa të vijen rezultatet e Testit. Rezultati i Testit vjen normalisht brenda 48 orëve.
- Në qoftë se ju vetë nuk keni simptoma, sqaroheni me punëdhënësin nëse duhet të shkoni në punë apo jo.
- Në qoftë se ju duhet të shkoni në punë, është e këshillueshme të mbani maskë për gojë dhe hundë, derisa të vijen rezultatet e Testimit të familjarit tuaj.
- Kolegjet / inën e punës mund të qëndrojnë dhe veprojnë komplet normalisht.

**Rezultati Negativ i Testit-
SARS-CoV-2**

- Në qoftë se familjarit juaj me të cilin jetoni bashkë i ka ardhur rezultati i testit Negativ, ju nuk jeni më pjesë e grupit me mundësi infektimi të lartë. Ju mund të jetoni normalisht jetën e përditshme, duke respektuar rregullat e përgjithshme të distancimit dhe të Higjenes.

**Rezultati pozitiv i Testit-
SARS-CoV-2**

- Zyra e shëndetësisë në Qark vendos për familjarin tuaj me rezultat pozitiv të Testit –Corona izolimin në shtëpi. Kjo i transmetohet gojarisht nepermjet telefonit dhe pastaj me shkresë postare.
- Në qoftë se është e mundur, ju duhet të ndaheni perkohësisht në ambiente dhe bashkjetesë me personin e izoluar.
- Nepermjet telefonit, në procesin e zbulimit të personave që kanë kontaktuar të izoluarin do të vendoset nëse edhe ju do të detyrohëni të hyni në izolim.
- Në qoftë se edhe ju urdheroheni të hyni në izolim, menjëher lajmëroni punëdhënësin tuaj.
- Ju do të testoheni vetëm në qoftë se zhvillohen simptoma.

- Në qoftë se rezultati i Testimit është pozitiv, qëndroni në izolim në shtëpi deri sa Zyra e shëndetësisë të ju heqë izolimin (jo më përpara se 10 ditë nga fillimi i infektimit, dhe duke parë zhvillimin e sëmundjes). Nuk ka Test të dytë. Heqja e izolimit si fillim bëhet nepermjet telefonit dhe pastaj edhe në rrugë postare.
- Në qoftë se ju, si person i shëndetshëm, me kontakte të afërta, me urdher të Zyres shëndetësore jeni Testuar, zbatoni rregullat e përcaktuara nga Zyra shëndetësore.

**Rezultati i Testimit
të SARS-CoV-2-
është negativ.**

- Qëndroni në izolim.
- Ju duhet të vazhdoni të qëndroni ambjentalisht i ndarë nga pjesa tjetër e familjes.

**Rezultati i Testimit
të SARS-CoV-2-
është positive.**

- Izolimi vazhdon.
- Do të ketë në kohë të caktuara kontrolle mjeksore.
- Zyra shëndetësore do të zbulojë personat me të cilët ti ke patur kontakte, të cilët ndoshta duhet të hyjnë edhe ata në izolim.
- Personat që ti ke patur kontakt dhe shfaqin simptoma duhet të Testohen.